



JobKeeper Payment

Nën Pagesën “JobKeeper” të Qeverisë Australiane, biznset që kanë pasur pasoja ekonomike nga Koronavirusi do të kenë mundësi të kenë akses për një subvencionim që të kenë mundësi të vazdojnë t’i paguajnë punonjësit e tyre.

Përgjigja Ekonomike Ndaj Koronavirusit

Punonjësit që e kanë pësuar, do të kenë mundësi të bëjnë kërkesë për një pagesë dy-javore prej \$1,500 për secilin punonjës të cilit i takon, që nga data 30 Mars 2020 deri më 27 Shtator 2020.

Pagesa “JobKeeper Payment” siguron që punonjësit të jenë të lidhur me vendin e punës, do t’i ndihmojë bizneset të ri-fillojnë me të shpejtë kur kriza të ketë kaluar.

Kjo pagesë është pjesë e planit të Qeverisë për të zbutur pasojat ekonomike të Koronavirusit dhe të ndihmojë në ndërtimin e një ure për rikuperim.

Informacoin i rëndësishëm për punëdhënësit

Që ta marrin pagesën “JobKeeper Payment” punëdhënësit duhet të regjistrojnë qëllim e tyre për të aplikuar në faqen e internetit të Zyrës së Taksave Australiane (ATO) www.ato.gov.au.

Punëdhënësit duhet gjithashtu të vlerësojnë nëse kanë ose do të pësojnë rënie të kërkuar të qarkullimit (turnover) — për shumicën e bizneseve më të vogla që është një zvogëlim i të ardhurave prej 30 % ose më shumë që nga data 1 Mars 2020 për një periudhë minimale 1 muaj.

Organizatat jo-fitimprurëse, duke përfshirë ato bamirëse, si dhe individë të vetëpunësuar, (biznese pa punonjës që plotësojnë testet e qarkullimit dhe kërkesat e pranueshmërisë mund të aplikojnë) gjithashtu për pagesën e mbajtësit të punës “ JobKeeper Payment.”

Si pjesë e procesit, punëdhënësit duhet të japin informacione Zyrës së Taksave Australiane rreth punonjësve të cilëve ju takon pagesa. Informacioni përfshin numrin e punonjësve që ju takon që nga data 1 Mars 2020 si dhe ata që janë aktualisht të punësuar nga biznesi (duke përfshirë ata që janë pushuar dhe janë ri-punësuar.)

Punëdhënësit të cilëve ju takon, do të marrin pagesën “JobKeeper Payment” që nga java e parë e Marsit..

Informacion i Rëndësishëm për Punonjësit

Nëse jeni punonjës, punëdhënësi juaj do t’ju njoftojë nëse kërkojnë Pagesën e Punës në emër tuaj,- shumica e punëtorëve nuk do të duhet të bëjnë asgjë më tej.

Punonjësit me orar të plotë dhe të pjesëshëm, përfshirë punonjësit e pushuar nga puna, kanë të drejtë të marrin Pagesën “JobKeeper Payment.”

Në rastin kur një punonjës “casual” (pa të drejta të plota) ka punuar me punëdhënësin e vet me një bazë të rregullt dhe sistematike, për së pakut 12 muajt e fundit, që nga data 1 Mars 2020, këtyre punonjësve gjithashtu do t’ju takojë kjo pagesë. Punonjësve që ju takon janë si më poshtë:

- Qytetarët Australian
- një person me vizë permanente
- një person me Vizë të Kategorisë Speciale (Nënklasi 444)

Nëse ju takon me ligj, Pagesa “JobKeeper Payment” do të subvencionojë një pjesë të të gjithë të ardhurave tuaja - punëdhënësi juaj do jetë përgjegjës, t’ju paguajë përmes sistemit të tyre të pagave.

Punonjësve që ju takon, do marrin minimalen \$1,500 për çdo dy javë (para heqjes së taksave), Asnjë pagesë e garancisë të fondit “superannuation” nuk kërkohet të paguhet mbi çdo pagesë shtesë të bërë për shkak të pagesës “JobSeeker.”

Nëse ju zakonisht merrni më pak se \$1,500 të ardhura në dy javë, (para se të hiqen taksat), punëdhënësi juaj duhet t'ju paguajë minimalisht, \$1,500 në dy jave (para se të hiqen taksat.)

Nëse aprovohet një kërkesë për pagesën “JobKeeper Payment”, por ju aktualisht merrni pagesën “JobKeeper” ose ndonjë pagesë tjetër të ardhurash për t'ju ndihmuar, duhet ta njoftoni organizatën “Services Australia” rreth situatës tuaj të ndryshuar, ose mund të pësoni një borxh që do të duhet të shlyhet.